



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. prot.

Tiranë, më 16.3 .2018

Lënda:

Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1748, datë 15.04.2015.

SHOQËRISË "BEJLERI ALFA" SH.P.K

Bulevardi "Dëshmore e Kombit",

Kullat Binjake, Kulla nr.2, Kati 12-të, Hyrja 2, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Bejleri Alfa" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1748, datë 15.04.2015, për mineral rërë bituminoze, në objektin "Patos Fshat", Fier.

Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.5794, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5372, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1748, datë 15.04.2015, për mineral rërë bituminoze, në objektin "Patos Fshat", Fier, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitet 2016-2017, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1748, datë 15.04.2015, për mineral rërë bituminoze në objektin "Patos Fshat", Fier, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1748, datë 15.04.2015, për mineral rërë bituminoze, në objektin "Patos Fshat", Fier.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

